

VENDIM
Nr. 180, datë 9.3.2016

PËR PËRCAKTIMIN E SASISË MINIMALE TË BOKARBURANTEVE DHE TË LËNDËVE TË TJERA DJEGËSE, TË RINOVUESHME, QË DO TË PËRDOREN GJATË VITIT 2016 NË SEKTORIN E TRANSPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 9876, datë 14.8.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, për transport”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shoqëritë e tregimit me shumicë, të pajisura me licencë të tipit A, janë të detyruara që të tregtojnë biokarburante dhe lëndë të tjera djegëse, të rinovueshme, që përdoren në sektorin e transportit.

2. Sasia minimale e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, të rinovueshme, që përdoren në sektorin e transportit, për vitin 2016, është 10% e sasisë totale të nënprodukteve të naftës, të cilat tregtohen nga shoqëritë e tregimit me shumicë.

3. Organi shtetëror për kontrollin e respektimit të detyrimit, të përcaktuar me këtë vendim, është Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

4. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial është përgjegjës, për:

a) Respektimin e përdorimit të sasisë minimale të biokarburanteve dhe lëndëve djegëse, të rinovueshme;

b) Kontrollin dhe respektimin e treguesve cilësorë të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë, në formë të pastër ose të përzier;

c) Kontrollin dhe kryerjen e analizave, në laboratorin qendror të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, për sasi të importuara, para zhdoganimit, për sasi të biokarburanteve dhe lëndëve djegëse, të rinovueshme, të prodhuara në vend, si dhe për kontrollin përpara shpërndarjes në stacionet e shitjes së karburantit.

5. Për mosrespektimin e detyrimeve të këtij vendimi, zbatohet sanksioni i përcaktuar në shkronjën “g”, të pikës 1, të nenit 25, të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

6. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama